



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN **Nr. 31, Datë 24.04.2018**

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	Sha Ujësjellës Këlcyrë
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	• Në kuadër të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik konstatoi se, autoriteti kontraktor, nuk ka justifikuar përdorimin e procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, sipas përcaktimeve të nenit 33 pika 2/c, të ligjit të prokurimit publik, pasi emergjenca për objektin e prokurimit rezulton të ketë ardhur si pasojë e mosmarrjes së masave në kohë për zhvillimin e procedurave normale të prokurimit. • Autoriteti kontraktor, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik në kundërshtim me nenin 53/3 dhe 55/2 të ligjit të prokurimit publik, duke kualifikuar ofertuesin i cili nuk përmbush kriteret e pranimit.
Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 66 dhe 72, pika 2, të Ligjit

	Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik vendosi, të penalizojë me gjobë 4 (katër) persona në cilësinë e titullarit të AK dhe anëtarëve të njësisë së prokurimit, si dhe të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 3 (tre) personave në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.
--	---